



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHTETËRORE
(VETËM PËR SHKOLLAT ARTISTIKE)**

LËNDA:

ANATOMI ARTISTIKE

Koordinatorë: Majlinda Hala

VITI MËSIMOR 2011 – 2012

1. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Anatomi artistike” përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të “Anatomisë artistike” për shkollën e mesme artistike profesionale të sistemit 4-vjeçar.

Programi orientues për provimin me zgjedhje “Anatomi artistike”, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2011-2012, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme artistike dega “Art figurativ”, për nxënësit e interesuar dhe për specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit e lëndës “Anatomi artistike” të shkollave artistike, që do të përgatisin maurantët për provimin “Anatomi artistike”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore* që ata duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin “Anatomi artistike” si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar*, që duhet zbatuar me korrektësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit “Anatomi artistike”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi orientues “Anatomi artistike” synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë.

Programi orientues është strukturuar në bazë të disa rubrikave që janë:

1. Tematikat që përshkruajnë përmbajtjen e programit.
2. Përshkrimi i tematikës dhe objektivat.
3. Tabela e peshave.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe korrektësi nga secili prej grupeve të interesuara, sidomos kujdes duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit “Anatomi artistike”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Vëmendje duhet të tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program, me përqindjet që zënë këto tema në testin e provimit. Përgatitja e nxënësve për provimin “Anatomisë artistike” duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve të anatomisë dhe të aftësive të përcaktuara në program. Për të arritur këtë, herë-herë ata duhet t’u rikthehen edhe çështjeve të ndryshme, të cilat nuk janë parashikuar në program, por që përmbajnë informacion bazë për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim.

2. TEMATIKAT E PËRMBAJTJES SË PROGRAMIT

1. **Kafka** (*Cranium*)
2. **Skeleti i trungut**
3. **Kockat e gjymtyrëve të sipërme** (*Ossa membri superioris*)
4. **Kockat e gjymtyrës së poshtme** (*Ossa membri inferioris*)
5. **Muskujt e kokës**
6. **Muskujt sipërfaqësorë të shpinës**
7. **Muskujt e kraharorit**
8. **Muskujt e barkut**
9. **Muskujt e gjymtyrëve të sipërme**
10. **Muskujt e gjymtyrëve të poshtme**
11. **Zhvillimi i trupit të njeriut. Kanunet**

3. TEMATIKA

1. **Kafka** (*Cranium*)

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon formimin kockor të kafkës. Kafka ndahet në dy pjesë në atë trunore dhe të fytyrës. Çdo pjesë e kafkës ka formimin e saj kockor dhe funksional. Secila nga kockat ka karakteristikat e saj të ndërtimit dhe të funksionit në veçanti dhe në tërësinë e kafkës.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
1.	Kafka (<i>Cranium</i>)	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin ndërtimin e kafkës trunore dhe të fytyrës;- të njohin kockat e kafkës sipas anës funksionale;- të shpjegojnë ndërtimin e kafkës në përgjithësi dhe të kockave përbërëse në veçanti.

2. Skeleti i trungut

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon skeletin e trungut dhe pjesët e tij përbërëse, si: 1. *shtyllën kurrizore*, ndërtimin e saj, vendosjen, funksionin dhe lidhjen me pjesët e tjera të skeletit të trungu; 2. *Dërrasën e kraharorit*, ndërtimin e saj, pjesët përbërëse, funksionin dhe lidhjen me pjesët e tjera të skeletit të trungut; 3. *Brinjët dhe kafazin e kraharorit*, ndërtimin e tyre, pjesët përbërëse, funksionin dhe lidhjen me pjesët e tjera të skeletit të trungut.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
2.	Skeleti i trungut	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin formën, funksionin dhe ndërtimin e kolonës vertebrore;- të mësojnë ndërtimin e toraksit;- të shpjegojnë ndërtimin e skeletit të trungut.

3. Kockat e gjymtyrëve të sipërme (*Ossa membri superioris*)

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon skeletin e gjymtyrëve të sipërme. Skeleti i gjymtyrëve të sipërme është i formuar nga brezi i shpatullës dhe nga pjesa e lirë që formohet nga krahu, parakrahu dhe dora. Kjo tematikë përmban mënyrën e ndërtimit të kockave përbërëse, funksionimin dhe lidhjen midis tyre.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
3.	Kockat e gjymtyrëve të sipërme (<i>Ossa membri superioris</i>)	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin ndërtimin e kockave të gjymtyrës së sipërme sipas grupeve: <i>shpatullor, krahut, parakrahut dhe dorës</i>;- të shpjegojnë ndërtimin e skeletit të gjymtyrës së sipërme.

4. Kockat e gjymtyrës së poshtme (*Ossa membri inferioris*)

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon skeletin e gjymtyrës së poshtme, i cili formohet nga brezi i legenit dhe nga ai i lirë. Pjesa e lirë formohet nga skeleti i kofshës, kërcirit dhe këmbës. Kjo tematikë përmban mënyrën e ndërtimit të kockave përbërëse, funksionimin dhe lidhjen midis tyre.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
4.	Kockat e gjymtyrës së poshtme (<i>Ossa membri inferioris</i>)	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin ndërtimin e kockave të gjymtyrës së poshtme sipas grupeve: <i>kocka e pelvisit, kocka e kofshës, kockat e kërcirit dhe të këmbës</i>;- të shpjegojnë ndërtimin e skeletit të

	gjymtyrës së poshtme.
--	-----------------------

5. Muskujt e kokës

Përshkrimi i tematikës. Kjo tematikë shqyrton dhe analizon muskujt e kokës, të cilët i ndajmë në dy grupe: në muskujt përtypës dhe të mimikës. Kjo ndarje bëhet sipas zhvillimit funksional të tyre. Kjo tematikë përmban vendosjen e muskujve, shtrirjen dhe veprimin e tyre.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
5.	Muskujt e kokës	<ul style="list-style-type: none"> - Të njohin muskujt e kokës sipas funksionit të tyre të përtypjes dhe të mimikës; - të mësojnë emërtimin, origjinën dhe vendin ku përfundon muskuli, si dhe veprimin e tyre; - të shpjegojnë ndërtimin e muskujve të kokës, aq sa i nevojitet një artisti.

6. Muskujt sipërfaqësorë të shpinës dhe muskujt anësorë të qafës

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon muskujt sipërfaqësorë të shpinës dhe anësorë të qafës. Kjo tematikë përmban shtrirjen e tyre, origjinën, vendin ku kapen, si edhe veprimin.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
6.	Muskujt sipërfaqësorë të shpinës dhe muskujt anësorë të qafës	<ul style="list-style-type: none"> - Të njohin emërtimin, origjinën dhe vendin ku kapen muskujt sipërfaqësorë të shpinës dhe muskujt anësorë të qafës; - të shpjegojnë muskujt sipërfaqësorë të shpinës dhe anësorë të qafës.

7. Muskujt e kraharorit

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon muskujt e kraharorit të regjionit të përparmë dhe anësorë. Kjo tematikë përmban vendosjen, shtrirjen, origjinën ku kapen dhe veprimin.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
7.	Muskujt e kraharorit	<ul style="list-style-type: none"> - Të njohin muskujt e kraharorit të regjionit të përparmë dhe anësorë; - të njohin emërtimin, origjinën ku kapet dhe veprimin e tyre; - të shpjegojnë ndërtimin e muskujve të kraharorit, aq sa u intereson artistëve.

8. Muskujt e barkut

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon muskujt e përparmë dhe anësorë të barkut. Kjo tematikë përmban vendosjen, shtrirjen, origjinën ku kapen dhe veprimin.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
8.	Muskujt e barkut	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin muskujt e murit të përparmë dhe muskujt anësorë të barkut;- të njohin emërtimin, origjinën, vendin ku kapet dhe veprimin e muskujve të lartpërmendur;- të shpjegojnë ndërtimin e muskujve të barkut, aq sa është e nevojshme për artistët.

9. Muskujt e gjymtyrëve të sipërme

Përshkrimi i tematikës. Kjo tematikë shqyrton dhe analizon muskujt e gjymtyrëve të sipërme, si: ato të shpatullës, të krahut, të parakrahut dhe të dorës. Kjo tematikë përmban vendosjen, shtrirjen, origjinën ku kapen dhe veprimin.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
9.	Muskujt e gjymtyrëve të sipërme	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin emërtimin, origjinën, vendin ku kapen dhe veprimin e tyre;- të mësojnë emërtimin, origjinën, vendin ku fiksohen dhe veprimin e muskujve të krahut, të parakrahut dhe të dorës;- të shpjegojnë muskujt e shpatullës, aq sa është e nevojshme për artistin;- të shpjegojnë muskujt e krahut, të parakrahut dhe të dorës, aq sa është e nevojshme për artistin.

10. Muskujt e gjymtyrëve të poshtme

Përshkrimi i tematikës. Kjo tematikë shqyrton dhe analizon muskujt e gjymtyrëve të poshtme, si: ato të legenit, kofshës, kërcirit dhe këmbës. Kjo tematikë përmban vendosjen, shtrirjen, origjinën ku kapen dhe veprimin.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
10.	Muskujt e gjymtyrëve të poshtme	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin emërtimin, origjinën, vendin ku kapen dhe veprimin e muskujve të legenit;- të njohin emërtimin, origjinën, vendin ku kapen dhe veprimin e muskujve të kofshës;- të njohin emërtimin, origjinën, vendin ku kapen dhe veprimin e muskujve të kërcirit dhe këmbës;- të shpjegojnë muskujt e legenit;- të shpjegojnë muskujt e kofshës;- të shpjegojnë muskujt e kërcirit dhe këmbës.

11. Zhvillimi i trupit të njeriut. Kanunet

Përshkrimi i tematikës. Kjo tematikë shqyrton dhe analizon karakteristikat e jashtme të trupit të njeriut në momente kyç të zhvillimit të tij fizik. Po kështu, shpjegon dallimin dhe karakteristikat midis trupit të mashkullit dhe femrës; raportet kryesore të trupit të njeriut sipas seksit dhe moshës. Kjo tematikë, gjithashtu, përmban edhe njohuri mbi kanunet, si: egjiptiane, greke dhe të rilindjes, rregulla që kanë shërbyer për artistët në kohë të ndryshme për të krijuar figurën e njeriut në përpjesëtime të drejta.

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
11.	Zhvillimi i trupit të njeriut. Kanunet	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin karakteristikat e trupit të njeriut në momente kyçe të zhvillimit të tij;- të njohin raportet e trupit të njeriut;- të shpjegojnë kanunet greke, egjiptiane, të rilindjes.

4. TABELA E PESHËS SË TEMATIKAVE NË PËRQINDJE

Tematika	Përqindja
Kafka (<i>Cranium</i>)	9 %
Skeleti i trungut	12 %
Kockat e gjymtyrëve të sipërme (<i>Ossa membri superioris</i>)	11 %
Kockat e gjymtyrës së poshtme (<i>Ossa membri inferioris</i>)	11 %
Muskujt e kokës	7 %
Muskujt sipërfaqësorë të shpinës	6 %
Muskujt e kraharorit	6 %
Muskujt e barkut	6 %
Muskujt e anësisë së sipërme të ndarë sipas zonave	14 %
Muskujt e anësisë së poshtme të ndarë sipas zonave	14 %
Zhvillimi i trupit të njeriut. Kanunet	4%
Gjithsej:	100 %